



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa: Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax: ++381(0)38 229 838, e-mail: bspk@etuc.org



- **Punimet e Këshillit Drejtues të BSPK-së**

**Prishtinë, 14 mars 2011-** Nën kryesinë e Haxhi Arifit, kryetar, më 9 mars 2010, është mbajtur mbledhja e rregulltë e radhës e Këshillit Drejtues të BSPK-së. Kryetari i BSPK-së theksoi se vendimet e nxjerra në mbledhjet e Këshillave Drejtues të mëhershme mbesin të zbatueshme dhe duhet të respektohen, gjithashtu është kërkesë e ITUC-ut që në Kongres të shkojmë me numër real të delegatëve e jo me numra fiktiv. Pikë e rendit të ditës ishte pregaditja për Kongresin V të BSPK-së. data 19 Mars është caktuar si datë orientuese për mbajtjen e Kongresit V-të të BSPK-së. Mirëpo, në ndërkohë kanë arritur kërkesa nga dy degë të BSPK-së, përkatësisht SBASHK-u dhe SP Policisë, për shtyerjen e Kongresit. Me qëllim të vlerësimit të gjendjes reale të anëtarësisë nëpër Degët e BSPK-së dhe me qëllim të daljes me numrat real, të delegatëve të mandatuar, për përfaqësim të degëve në Kongresin V-të të BSPK-së, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me dt. 09.03.2011, mori këtë: **VENDIM:** Formohet Komisioni për verifikimin e anëtarësisë reale të anëtarëve në Degët e BSPK-së. Komisioni ka në përbërje 5 anëtarë: Ali Shabanaj, Blerim Sylja, Valbona Kamberi, Izet Mustafa dhe Ismet Mehmeti. Numri definitiv i

anëtarësisë sindikale të SP-ve, për përfaqësim, do të merret nga listat e pagave të muajit Mars, respektivisht Prill 2011. Duke parë gjendjen reale të anëtarësisë në Degët e BSPK-së, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me dt. 09.03.2011, mori këtë: **VENDIM:**

SP THT, SPEVZ, SP Pylltarisë, SP Minatorëve, SP Tekstilit, SP Komunikacionit, SP Metalurgjisë, SP Industrisë Kimike dhe Jometaleve, SP Pensionistëve si dhe Sindikata e Kombinatit “Trepça”, nuk i plotësojnë kriteret e Statutit të BSPK-së për pjesëmarrje me të drejta të plota në Kongresin V-të të BSPK-së. Degët në fjalë do ta kenë statusin e vëzhguesit, ndërsa në momentin që ato i plotësojnë kriteret statutare, ose duke u fuzionuar mes veti sipas lēmive të përfaqërta, do të rikthejnë statusin e degës më të drejta të plota në BSPK-ë.

Në Kongresin V-të TË BSPK-së do të përfaqësohen këto degë: SBASHK-u, FSSHK-ja, SPK-ë, SPEK-u, SPJK-ë, SPAK-ë, SP VKBK-ë, SPMK-ë, SPAGK-ë, SPNPK-ë dhe SP Metalurgjisë dhe Industrisë Kimike, nëse i kryejnë obligimet financiare ndaj BSPK-së.

Data e caktuar e mbajtjes së Kongresit (19.03.2011), është shtyer për më vonë, ndërsa si propozim ishte maji 2011.

**Zyra për Informim, BSPK**  
**Fatma Rastelica**